

KONTRATË PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SË PËRBASHKËT ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR SHQIPTARO-ÇEKO-BRAZILIANE ME EMËRTIM "A.B.C.D. Sh.P.K."

N D E R M J E T

1. P a lës shqiptare me seli në Tiranë ,Rr."Qemal Stafa"Nr.395/1-4
Tiranë -Shqipëri ,e përfaqshuar nga Z.Spartak Shiko
2. Shoqërisë me veprimtari të caktuar "Lusiana S.r.o. me seli në Pragë
Çeki,Siroka 22 ,Praha 1 , përfaqshuar nga drejtori i saj Z.Ruy Alves
3(Firmës),Shoqërisë "Lusiana do Brasil,Comercio International,Brazil,
Rio de Janeiro,Av.Rio Branco ,177-7 e andar me seli në Rio de Janeiro
Brazil përfaqshuar nga drejtori i saj Z.Ruy Alves.

Në përputhje me ligjin No.7512 datë 10.08.1991 të Kuvendit Popullor
të Republikës së Shqipërisë ,palët ranë dakort si më poshtë:

N E N I 1

Të krijohet(firma) Shoqëria e përbashkët me përgjegjësi të kufizuar
shqiptaro-çeke - braziliane për zhvillimin e një veprimtarie të përbashkët
ekonomiko-industriale e cila do të ketë këtë emërtim:

"A.B.C.D. Sh.P.K."

në shqip

"A.B.C.D. S.r.o. "

në çekisht

"A.B.C.D. Ltda "

në portugalisht

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë ,Rr."Qemal Stafa" pallati nr.
395 shk.1 Ap.4,në Republikën e Shqipërisë dhe dega do të jetë në
Republikën Çeke në Pragë me adresë Praha 1 Siroka 22.

N E N I 2

Në përputhje me legjislacionin shqiptar Shoqëria e mësipërme është
person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do të disiplinohet sipas
dispozitave të kësaj kontrate , të statutit të saj dhe të legjislacionit
Shqiptar.

Statuti i kësaj Shoqërie i Bashkëngjitet kësaj kontrate dhe përbën një
pjesë të pandarë të saj.

Shoqëria përgjigjet vetëm për pasurinë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet
për detyrimet e ~~statutit të saj~~ pjesëtarëve të saj.

Po kështu Pjestarët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e Shoqërisë
dhe nuk mund t'i ndajnë humbjet ndryshe veçse deri në madhësinë
e pjesës që ata kanë vendosur.

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas

N E N I 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria themelohet me qëllim që të zhvillojë veprimtari në këto fusha:
-Importimi ,shpërndarja dhe shitje të pjesëve të ndërit për vetura dhe
kamionë , teknikës bujqësore ,makinerive të ndërtimit dhe pjesëve e pa
sjeve të tjera të këtij lloji

- Veprimtari projektuese duke përfshirë edhe realizimin e punës ndë-
timore ,lëvrimi komplet i paisjeve për realizimin e ndërtimit duke pë-
fshirë edhe shfrytëzimin e mëtejshëm të këtyre ndërtimeve
- Fusha e sbatimit të ndërtimeve (veprimtari e organit sbatues)ndërtimi
dhe rikonstruksioni i ndërtësive të banimit dhe i objekteve të tjera
- Kryerja e shërbimeve në hotela dhe restorante ,veprimtari këmbëse të
monedhës dhe veprimtari në fushën e turizmit.
- Veprimtari për sbatimin e asaj pjese të programit ekologjikut prodhimet
bujqësore pas përpunimit të produkteve
- Veprimtari projektuese ,krijuese dhe hulumtuese në fushën e lulishtve
parqeve dhe gjelbërimit përrreth banesave.
- Importimi dhe shitja e mallrave në territorin e Shqipërisë.
- Pjesëmarrje në themelimin e shoqërive tregtare bija dhe shoqërive të për-
bashkëta me pjesëmarrjen e kapitaleve të tjera
- Kryerja të transportimeve ajrore ,sistematike dhe jo sistematike (brë-
nda dhe jashtë vendit)të personave dhe mallrave kundrejt pagesës dhe
kjo si me avionat e saj ashtu dhe të marrë me qira.
- Kryerja e punëve të ndryshme me avionë kundrejt pagesës,sic janë krye-
sisht fotografime dhe filmime ajrore ,ekskursione dhe ushtrime mësimore
etj dhe këto me aviona të saj dhe me qira ,brënda dhe jashtë vendit.
- Sigurimi i kontrollit dhe riparimi periodik i avionave në përputhje me
kërkesat e kualifikimit të vendosura nga inspektorikati ajror shtetror.
- Marrja me qira e avionave dhe e personelit të tyre nga agjensitë ajrore
të tjera dhe dhënia me qira e avionave dhe e personelit të tyre
agjensive të tjera ajrore si në vend ashtu dhe jashtë.
- Shitja e biletave të avionave të saj dhe ndërmjetësimi për shitjen
e biletave të avionave të tjerë,të agjensive të tjera ajrore
- realizimi i veprimtarisë regulluese ,konsultuese ,eksportuese ,të mar-
ketingut dhe të ndërmjetësimi në fushat e mësipërme që përbëjnë obj-
ektin e veprimtarisë duke përfshirë edhe përeaktimin dhe realizimin e
kontakteve të nevojshme në këto fusha si në Shqipëri ashtu dhe jashtë
vëndit
- Në Shoqëria do të japë ndihmë gjatë realizimit të veprimtarisë në
fushat e mësipërme dhe do të merret me studime ,teknologji ,veprimtari
regulluese për problemet e paisjeve si në territorin e Shqipërisë ashtu
edhe gjatë eksportit jashtë territorit të saj
- Shoqëria këtë veprimtari të saj mund t'a kryejë vetë ose në bashkëpunim
me persona të tjerë Juridik dhe financiar,shqiptar ose të huaj

N E N I 4

Veprimtaria e Shoqërisë mbaron më datë 31 Dhjetor 2021, por mundet që
me shumicën absolute të vendoset ndërprerja ose agjatja e saj ,Kjo kontratë
kontratë dhe anekset e saj përfaqsojnë një marrëveshje të plotë ndë

mjet palëve kontraktuese .Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim midis palëve

N E N I 5

KAPITALI BAZË

Kapitali Basë(themelox) i Shoqërisë është i përbërë nga 100.000 lek (njëqindmijë lek) dhe do të krijohet si në formën e parave ashtu edhe të sendeve materiale

Kapitali basë do të krijohet nga palët sipas përpjestimit të mëposhtëm:

1.Pala shqiptare 33,3 %

2.Pala Ceke Spol S.r.o. 33,3 %

3.Pala braziliane "Luziana de Brazil 33,3 %

Pjestarët Cek dhe Brazilian do ta derdhin kontributin e tyre në mënyrë të tillë që të sigurohet lindja dhe zhvillimi i Shoqërisë së përbashkët , domethënë dhënia e mjetve financiare,që janë vlera e kontributit në momentin e lindjes së Shoqërisë.

Pjestari shqiptar do të sigurojë për veprimtarinë e Shoqërisë ambjente e syrave si dhe paisjet e nevojshme për veprimtarinë e Shoqërisë dhe personelin vendas të nevojshëm sipas kërkesave të paraqitura nga Shoqëria.

Këta partnerë gjithashtu do të sigurojnë udhëheqjen e kualifikuar të Shoqërisë dhe do të japin në të përvojën e tyre personale dhe "Know-How" sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.

N E N I 6

Kapitali i Shoqërisë përfaqshet nga kapitali basë dhe të gjitha mjetet e tjera të njohura të nevojshme për punën e Shoqërisë.Mjetet e likuidimit dhe transaksionet financiare mund të bëhen si me llogarinë e krijuar në bankën e Shtetit Shqiptar ashtu edhe nëpërmjet bankave private shqiptare në të cilat Shoqëria hap llogari rrjedhëse të nevojshme

N E N I 7

Asambleja e ortakve do emëron Këshillin Administrativ i cili Zgjedh Kryetarin e saj dhe emëron drejtorin e Shoqërisë.

N E N I 8

Shoqëria fiton të drejtën të fillojë veprimtarinë e saj pas rregjistrimit në Gjykatën e Rrethit ,në Tiranë dhe pas depozitimit të vendimit përkatës në organin përkatës financiar të Rrethit.

Fitimi i Shoqërisë pas heqjes së detyrimeve ligjore dhe pjesës së fondit rezervë do të ndajë tatimin në madhësinë e vendosur nga Ministria Financave e Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet ekzistuese.Fitimi i pastër do të ndahet midis pjestarëve në përpjestim me pjesën e tyre në kapitalin basë

Fitimi dhe të ardhurat e tjera të partnerit të huaj mund të kalojnë lirisht në një menedhë të caktuar në llogarinë që ky pjestar cakton.

Pitimi do të tatchet në Shqipëri dhe jo në vëndin e qëndrimit të Pjestarit të huaj.

N E N I 9

Veprimtaria ekonomike dhe investimet e Pjestarit të huaj do të jenë nën mbrojtjen e Shtetit i cili garanton Shoqërisë të njëjtat kushtë të eilat vlejnë për personat Juridik shqiptar/.

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj vetëm me fondin e saj. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e Shtetit dhe të personave Juridik të tjerë.

N E N I 10

DETYRIMET E PJESTARIT TË HUAJ

Pjestarët e huaj janë të detyruar t'i japin Shoqërisë dokumentacionin teknik dhe teknologjik të plotë, ashtu sikurse është vendosur dhe të sigurojë realizimin e tij, të marrë pjesë në organizimin dhe pajimin e prodhimit, realizimin e prodhimit në sasinë dhe dhe cilësinë e duhur, të sigurojë shkollimin e personelit.

N E N I 11

DETYRIMET E PJESTARIT SHQIPTAR

Pjestari shqiptar është i detyruar të sigurojë për Shoqërinë e përbashkët shqiptare - eke-brasiliane me përgjegjësi të kufizuar "A.B.C.D. Sh.P.K." ,ndërtesën, paisjet e nevojshme dhe instalimet e nevojshme si është vendosur, si dhe fuqinë puntore personelin teknik e administrativ

N E N I 12

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e Shoqërisë janë:

Asambleja e ortakëve

Kryetari i Këshillit Administrativ.

-Drejtori

Mënyra e krijimit të kë organeve dhe e veprimtarisë së tyre janë të caktuara nga Statuti. Brënda tre javëve nga regjistrimi i Shoqërisë do bëhet mbledhja e Pjestarëve në selinë e Shoqërisë me qëllim që të caktohen përgjegjësitë

N E N I 13

Ortakët janë të detyruar të ruajnë reciprokisht dokumentat, informacionet, përvojën dhe dijet që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat që të kufizohet publikimi i tyre vetëm pjesërisht Pjestarët përgjigjen për çdo lloj dëmi që i shkaktohet Shoqërisë si pasëjë e mos kryerjes së detyrimeve nga ana e tyre.

N E N I 14

Fuqia e kësaj kontrate caktohet deri më 31 Dhjetor 2021 me mundësinë për t'u zgjatur ose për t'a ndërprerë në bazë të vendimit të shumicës absolute të pjestarëve.

N E N I 15

Kontrditat eventuale që mund të lindin ndërmjet palëve të kësaj

Kontrate dhe që nuk do të zgjidhen në prapësi e mirrëkuptimit do të k
kalojnë për t'u zgjidhur Gjyqit të Republikës së Shqipërisë sipas legjis
lacjonit në fuqi.
Kjo kontratë (marrëveshje) është bazuar në të drejtën Shqiptare.

N E N I 16

Hollësitë që kanë të bëjnë me Shoqërinë janë përshkruar në Statut.

N E N I 27

Kjo kontratë është përgatitur në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe atë
Çeke, që të dyja kanë të njëjtën vlerë.

Për palën Çeke

Z. Ruy Alves

Për palën Shqiptare

Z. Spartak Shiko

Për palën braziliane

Z. Ruy Alves

Tiranë më 15.10.1993

[Handwritten signatures]



STATUT

I

SHOQËRISË SË PËRBASHKËT ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SHQIPTARO-ÇEKE --
BRAZILIANE " A . B . C . D . Sh.P.K." "

K R E U I

D I S P O Z I T A T Ë P Ë R G J I T H S H M E

N E N I 1

Ndërmarja quhet :

- NË shqip "A.B.C.D. Sh.P.K."
- NË çekisht "A.B.C.D. S. r.o."
- NË portugalisht "A.B.C.D. L.t.d."

Shoqëria është person Juridik shqiptar.

Shoqëria fiton të drejtën e personit Juridik që nga data e rregjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës dhe në organin Financiar Kompetent ,përcaktuar në bazë të vend-ndodhjes së selisë së aktivitetit ekonomik e social.

Shoqëria e kryen aktivitetin e saj në bazë të Legjislacionit shqiptar si dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj (kontrata) dhe këtij Statuti.

N E N I 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria themelohet me qëllim që të zhvillojë veprimtari në këto fusha -Importimi,shpërndarja dhe shitja e pjesëve të ndërtimit për autovetura dhe kamiona ,të teknikës bujqësore ,makinerive të ndërtimit dhe pjesëve e paisjeve të tjera të këtij lloji.

-Veprimtari projektuese duke përfshirë dhe realizimin e punës ndërtimore,lëvrimi komplet i paisjeve për realizimin e ndërtimit ,duke përfshirë dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të këtyre ndërtimeve.

-Fusha e zbatimit të ndërtimeve (veprimtaria e organit të zbatimit) ndërtimi dhe rikonstrukcioni i ndërtesave të banimit e objekteve të tjera.

-Kryerja e shërbimeve në hotele dhe restorante,veprimtari këmbyses të monedhës dhe veprimtari të fushës së turizmit

-Veprimtari për zbatimin e asaj pjese të programit ekologjik të prodhimeve bujqësore pas përpunimit të produkteve.

-Veprimtari transportuese ,dhënie hua të kamionave dhe veturave.

-Veprimtari projektuese,krijuese dhe hulumtuese në fushën e lulishteve parqeve të gjelbërimit përreth banesave.

-Importimi dhe shitja e mallrave në territorin e Shqipërisë.

- Pjesmarje në themelimin e shoqërive tregtare bija dhe shoqërive të përbashkëta me përgjegjësi të kufizuar me pjesmariën e kapitaleve të tyre.
- Kryerjen e transportve ajrore sistematike dhe jo sistematike (brënda dhe jashtë vendit) të personave dhe mallrave kundrejt pagesës, kjo si me avionat e e saj ashtu edhe të marrë me qira.
- Kryerja e punëve të ndryshme me aviona kundrejt pagesës ,si janë fotografime dhe filmime ajrore, eskursionë dhe ushtrime mësimore etj., edhe këto me avionë të saj dhe me qira, brënda dhe jashtë vendit.
- Sigurimi i kontrollit dhe riprimi periodik i avionave në përputhje me kërkesat e kualifikimit të vendosura nga inspektoriat ajror shtetror.
- Marja me qira e avionave dhe e personelit të tyre nga agjensitë etjere ajrore dhe dhënia me qira e avionave dhe e personelit të saj agjensive të tjera ajrore si në vënd ashtu edhe jashtë.
- Shtja e biletave të avionave të saj dhe të ndërmjetsoj për shitjen e biletave të avionave të agjensive të tjera ajrore.
- Realizimi veprimtarisë rregulluese ,konsultuese ,eksportuese,të marketingut dhe të ndërmjetësimi në fushat e mësipërme që përbëjnë objektin e veprimtarisëduke përfshirë dhe përcaktimin dhe realizimin e kontakteve të nevojshme në këto fusha si në Shqipëri dhe jashtë vendit
- Shoqëria do të japë ndihmë gjatë realizimit të veprimtarisë në fushat e mësipërme dhe do të merret me studime ,teknologji,veprimtari rregulluese për problemet e paisjeve si në territorin e Shqipërisë ashtu edhe gjatë eksportit jashtë territorit të saj.
- Shoqëria këtë veprimtari të saj mund t'a kryejë vetë ose në bashkëpunim me persona të tjerë Juridik ose fizik shqiptar dhe të huaj.

Veprimtaritë e mësipërme kanë për qëllim arritjen e objektivave të sipërpërmëndura ,në përputhje me ligjet që rregullojnë këto aktivitete në Republikën Shqipërisë,konform programit të aktivitetit ekonomik financiar të parashikuar dhe aprovuar nga Këshilli Drejtues i Shoqërisë.

N E N I 3

Shoqëria e ka selinë në Tiranë,në rrugën "Qemal Stafa " pallati Nr.395 shkalla 1 apart. 4. dhe dega do të jetë në Pragë,Siroka 22, Praha 1 në Republikën Çeke. Ajo mund të hapë filiale dhe degë ose derivate të saj në Shqipëri dhe jashtë saj.Njësitë strukturore ,filialet dhe përfaqsitë dotë krijohen në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe atë të vendeve të huaja ku do të kenë selinë

N E N I 4

Në përputhje me legjislacioni shqiptar Shoqëria është person Juridik dhe veprimtaria e saj do të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate dhe të statutit të saj si dhe të legjislacionit shqiptar.

Statuti i Shoqërisë i bashkëngjitet kontratës dhe është një pjesë e pandarë e saj.

Shoqëria përgjigjet vetëm për pasuritë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e antarëve të saj (pjestarëve të saj)

Po kështu pjestarët nuk përgjigjen personakisht për detyrimet e Shoqërisë dhe nuk mund t'i ndajnë humbjet ndryshe, veçse deri në madhësinë e pjesës që ata kanë vendosur.

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas

N E N I 5

Ortakëjt kanë detyrimet kryesore të mëposhtme, që do të ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra në Asambëlënë e ortakëve:

-Pjesmarje në drejtimin e aktivitetit ekonomik - tregtarë të Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe statutin.

-Pjesmarje në rezultatet e ofardo forme dhe sasia të aktivitetit ekonomik, parashikuar nga kontrata dhe statuti.

-Pjesmarje me anë të përfaqësuesve të përcaktuar prej tyre, në të gjitha organet e Shoqërisë.

-Të kërkojnë dhe t'u vihen në dispozicion, të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me gjëndjen tregtare dhe aktivitein social, bilancet dhe llogaritë ekonomike.

-Të paraqesin propozimet e tyre dhe t'ia nështrajnë ato shqyrtimit të Këshillit drejtues dhe organeve të tjera të Shoqërisë.

-Të tërhiqet nga Shoqëria duke i ofruar kuotën e tij Pjestarëve të tjerë të dhe t'ia kalojë atë të tretëve vetëm në rast se Pjestarët nuk e pranajnë.

K R E U I I

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

N E N I 6

Ortakëjt kanë detyrimet kryesore të mëposhtme:

-Të depozitojnë kuotën që ju takon si dhe ato suplementare në përputhje me aktet e krijimit të Shoqërisë që janë kontrata dhe statuti.

-Të marrin pjesë në drejtimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të caktuara prej tyre,

-Të furnizojnë Shoqërinë me informacionet e nevojshme për përpunimin e çdo objekti të veçantë që ka lidhje me aktivitetin e Shoqërisë.

-Të kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe funksioneve të Shoqërisë.

Ortakëjt janë të detyruar të ruajnë reciprokisht dokumentat,

informacionet ,përvojën dhe dijet që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat që të kufizohet publikimi i tyre e edhe vetëm pjesërisht.

-Pjestrët përgjigjen për çdo lloj dëmi që i shkaktohet Shoqërisë si pasojë e moskryerjes së detyrimeve nga ana e tyre.

N E N I 7

-Çdo(ortak) pjesmarrës ka të drejtë të tërhiqet nga Shoqëria duke njoftuar për vendimin e tij Këshillin Drejtues një vit më parë duke respektuar Nenin 5 të këtij Statuti.Tërheqja nga Shoqëria nuk e çliron Pjestarin nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj Shoqërisë dhe po kështu nuk pezullon ato të marra nga Shoqëria ndaj Pjestarit. Pjestari mund t'ua shesë të tretëve aksionet e tij me çmim jo më të ulët se ai i ofruar Pjestarëve të tjerë ,përveç sa është vendosur në Nenin 5 .

K R E U I I I

KUSHTET EKONOMIKE

N E N I 8

Aktiviteti i Shoqërisë realizohet në bazë të principeve të llogarisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

N E N I 9

Me qëllim që të zhvillohet aktiviteti i Shoqërisë ,krijohet kapitali bazë prej Lek 100.000(njëqind mijë lek) që është njëkohësisht edhe fondi fillestar për të furnizuar fondin bazë dhe atë qarkullues. Pjestarët marrin pjesë në krijimin kapitalit themelor (bazë) me pjesën e kuotës së tyre të parashikuar në aktet e krijimit të Shoqërisë (sic është kontrata dhe statutit)

Mënyrat dhe skadencat e derdhjes së kuotave të kapitalit bazë do të fiksohen nga Drejtori i Shoqërisë.Drejtori i Shoqërisë i dorrëzon Pjestarëve një dokument që konfirmom shumën e derdhjeve të kryera.

N E N I 10

Në rastin se Shoqëria shpërndahet ,pasi të jenë paguar të gjitha pasivitetet,pjesa që do të mbetet do të ndahet ndërmjet pjestarëve në përputhje me raportin e kuotës së derdhur.

N E N I 11

Shoqëria në emër të saj është pronare,përdor dhe disponon pasuritë e sa në përputhje me destinacionin e tyre dhe objektin e veprimtarisë së Shoqërisë .

Shoqëria mund të blejë dhe të shfrytëzojë edhe materiale të tjera duke inkluduar të drejtën të ofrojë pasurinë e saj dhe të marrë Kredi nga Bankat.

Në Republikën E Shqipërisë ,Shoqëria gëzon të drejtën të mbrojë pasuritë e saj ashtu sic e do Shoqëri ose organizatë industriale-tregtare

Kombëtare ,në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe ndryshimet plotësuese eventuale që mund t'i bëhen atij.

N E N I 12

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të vecanta financimi (për zhvillimin, stimulimin ekonomik, në lek ose në valutë etj). Përbërja, shuma e përgjithshme ,burimet për krijimin e fondit përdorim dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Këshilli Drejtues në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Shoqëria i disponon tërësisht mjetet e saj financiare . Pasivitetet që mund të lindin gjatë aktivitetit të saj do të mbulohen nga Fondi i rezervës dhe fonde të tjera si dhe nga shuma të mundëshme suplementare të derdhura nga pjestarët në rast se ato nuk mund të mbulohen nga fondet egzistuese.

N E N I 13

E ardhura bruto e Shoqërisë ,pasi të zbriten të gjitha shpenzimet, duke përfshirë aty amortizimin ,pagat ,shpenzimet e blerjes së materialeve,mjeteve ,pajisjeve të nevojshme etj, të nevojshme për zhvillimin aktivitetit ekonomik-tregtar të Shoqërisë,do të ndahet ndërmjet pjestarëve në proporcion me kuotën e pjesmarjes në kuotën e Kapitalit Bazë d.m.th. 1/3 secilli.

Fideli qëi takon pjesmarësve të huaj ,pasi të paguhet taksat që zbatohen në Shqipëri ,mund të transferohen jashtë shtetit pa asnjë pengesë.

N E N I 14

Pasuritë e Shoqërisë do të vlerësohen në bilancet e saj me vlera të shprehura në monedhë Shqiptare dhe të huaj,në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë ,me përjashtim të rasteve kur Ministria e Finacave do të përcaktojë valutë tjetër. Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike të Shoqërisë ,do të përcaktohet nga Këshilli drejtues i Shoqërisë dhe në bazë të formave dhe bilanceve dhe llogarive ekonomike të përcaktuara për organizatat dhe Shoqëritë industrialo-tregtare në Shqipëri.

Bilancet vjetore duhet të paraqiten brënda 31 Marsit të vitit pasardhës.

N E N I 15

Aktiviteti financiar i Shoqërisë do të realizohet në bazë të programeve financiare që bëjnë pjesë në aktivitetin ekonomik-tregtar. Planet financiare parashikojnë aktivin dhe pasivin e veprimtarisë së Shoqërisë të shprehura në valutë të konvertueshme.

Llogaria kontabile dhe ajo ekonomike do të mbahen në Lek shqiptar ose dollar USA.Rezultatet financiare të veprimtarisë sociale dhe ekonomike do të përcaktohen në bazë të bilanceve vjetore.

Këmbimi i monedhës shqiptare me monedhën e huaj dhe anasjelltas do të bëhen në përputhje me kursin e vendosur nga Banka e shtetit shqiptar

N E N I 16

Organi vendimor i Shoqërisë është Asambleja e ortakve... drejtohet nga Kryetari i këshillit Drejtues që vetë ajo e ka zgjedhur. Asambleja e ortakve vendos mbi bilancet vjetore (mirratimin ose mosmirratimin), ndryshimin e neneve të kontratës dhe të Statutit, bën zgjedhjen e këshillit Administrativ dhe të Drejtorit të cilin e cakton këshilli drejtues. Ajo vendos për shpërndarjen ose jo të Shoqërisë. Me unanimitet të Pjestarëve do të merren vendimet e mëposhtme:

- ndryshimi i Kontratës dhe i Statutit .
- rritja ose pakësimi i kapitalit bazë të Shoqërisë.
- zgjatje të kohës së veprimtarisë së Shoqërisë
- shpërndarja e Shoqërisë

Vendimet që kanë të bëjnë me çështje të tjera, mbledhja e pjestarëve i merr me shumicën e 2/3 të saj. Në rast të votave të barabarta, vendos Drejtori i Shoqërisë. Mbledhja e Pjestarëve bëhet të paktën një herë vit, me njoftim paraprakisht të paktën 30 ditë.

N E N I 17

Organi drejtues i Shoqërisë është këshilli Administrativ, i zgjedhur nga Asambleja e ortakve... Kryetari i këshillit Drejtues dhe Drejtori. Këshilli Drejtues nëpërmjet Drejtorit përfaqson Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët, brënda kufijve të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, përveç çështjeve që duhet të vendosen nga mbledhja e pjestarëve me unanimitet.

N E N I 18

Këshilli Administrativ është kompetent të marrë vendime në lidhje me çilindo aspekt të veprimtarisë së Shoqërisë. E drejta për të shtruar për diskutim një çështje në këshillin drejtues dhe të kërkojë shqyrtim prej saj i takon Pjestarëve si direkt ashtu edhe nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Kryetarit të këshillit drejtues dhe drejtuesve të filialeve që janë persona juridik.

Kompetencat ekzkluzive të Drejtorit të shoqërisë janë si më poshtë

-Thëret Mbledhjen e Pjestarëve

Në kuadrin e veprimtarisë të përcaktuar në Nenin 2 të këtij Statuti të mirratojë planet dhe llogaritë ekonomike pasi t'i ketë përpunuar, të bëjë ndryshime në listën e aktiviteteve dhe të shërbimeve që do të kryhen dhe që formojnë objektin e veprimtarisë së Shoqërisë .

- t'i propozojë Asamblejeve të ortakve ndryshimin e kapitalit bazë në rast nevoje .

- të përcaktojë rregjimin dhe kushtet e aplikimit të modalitetve të përcaktuara në ligj për përcaktimin e përcaktimit të llogarive ekonomike ,

- të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë, të përcaktojë organet dhe të shpërndajë postet drejtuese ndërmjet përfaqësuesve të Pjestarëve

- Të përcaktojë rregullin e derdjes së kuotave ,
- Të paraqesë në Asambliën e ortakëve , propozime për rregulloren ,për krijimin dhe destinimin e fondeve të vecanta ,rishpërndarjen e fitimit si dhe të përcaktojë rregulloren për eliminimin e e debiteve të ndryshme
- Të vendosë krijimin e njësisive strukturale ,filiale e përfaqsi ,mbylljen e aktivitetit të tyre në përputhje me marrëveshjet e organeve kompetente në Shqipëri dhe të vendëve ku e kanë selinë këto filiale
- të pregatisë propozimin për shpërndarjen e veprimtarisë së Shoqërisë
- Të zgjedhë aktarët për krijimin e komisionit për likuidimin që do të emërohen dhe revokohen nga Mbledhja e Pjestarëve.
- të procedojë për tërheqjen dhe likuidimin e fondeve me pjestarët që tërhiqen nga Shoqëria .
- Vendos lidhur me kërkesat dhe përdorimin e kredisë afatgjatë ;
- siguron ekzekutimin e saktë të vendimeve të mbledhjes së pjestarëve
- Hap letër kreditë në Lek dhe në Valutë të huaj.
- Nëshkruan Kontrata .
- Përcakton numrin e puntorëve dhe shumën e pagave të tyre?

N E N I 19

Drejtimi i veprimtarisë operative të ndërmarjes është kompetencë e drejtorit të Shoqërisë dhe përbën organin egzekutiv(ekzekutues)

Drejtori emërohet nga mbledhja e pjestarëve .

Drejtori,në kuadrin e kompetencave të përcaktuara nga ky statut dhe të vendimeve të mbledhjes së pjestarëve ,vepron në të gjithë sektorët e Shoqërisë për vazhdimësinë e realizimit të objektivit të veprimtarisë.

Drejtori i Shoqërisë ngarkohet me detyrat e mëposhtme:

-Organizon dhe ndjek të gjitha planet e Shoqërisë të përcaktuara nga mbledhja e pjestarëve.

Pasi të ketë marrë prokurë speciale ose të përgjithshme mund të paraqesë Shoqërinë para të tretëve ,në Gjykata dhe përpara arbitrave,të firmosë kontrata dhe në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe të sigurojë realizimin e tyre

N E N I 20

Drejtori i Shoqërisë i raporton Këshillit dhe mbledhjes së pjestarëve dhe është përgjegjës para tyre për gjëndjen e veprimtarisë së shoqërisë dhe realizimin e objektivave dhe funksioneve që ai ka kompetencë.

N E N I 21

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri ,në filialet e saj dhe në degëzime e përfaqsi rregullohen me kontratat e punës ,ku aplikohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar në fuqi.

K R E U V

SHPËRNDARJE E SHOQËRISË

N E N I 22

Veprimtaria e Shoqërisë përfundon më 31 Dhjetor 2021 ose edhe më

parë sipas propozimit të bërë nga njëri nga pjestarët e mbledhjes , kur aktiviteti i Shoqërisë për dy vite të njëpasnjëshme rezultoi jo fitim prurës ,ose në rastin kur të gjithë pjestarët përveç njërit tërhiqen nga Shoqëria, si dhe në të gjitha rastet e tjera të parrashikuara nga Statuti dhe Kontrata, Shpërndarja kryhet në formë riorganizimi ose likuidimi.

N E N I 23

Në rast se Shoqëria likuidohet :

Asambleja e ortakve emëron komisionin e likuidimit që i paraqet asaj bilancine likuidimit Shoqëria e mbyll aktivitetin e saj që nga casti i mirratimit të bilancit të likuidimit .

-Pronat e Shoqërisë dhe të filialeve që ndodhen në vëndet e pjestarëve ose në një vënd të tretë ,pasuritë që kanë vënë në dispozicion të Shoqërisë me të drejtën e përdorimit ,do t'i kthehen vëndit pronar dhe shumat e përdorimit do të llogariten në shumën që do t'i kthehet Pjestarit që vjen nga vëndi pronar.

Të ardhurat financiare që janë rezultat i vaprintarisë ekonomike të filialeve të saj po ashtu dhe fondet financiare do të ndahen ndërmjet pjestarëve në proporcion me kuotat e derdhura ,e gjithe kjo pasi të jenë shlyer të gjitha pagesat ndaj kreditorëve .

N E N I 24

Në rastin e mbylljes se aktivitetit të njëres prej filialeve si efekt i riorganizimit të saj ,mënyra e mbylljes së tij do të caktohet nga mbledhja e Pjestarëve në përputhje me marrëveshjet e arritura me autoritet kompetente të vëndit

Likuidimi i filialeve do të kryhet me po ato mënyra me të cilat do të kryhet shpërndarja e Shoqërisë .Mjetet financiare të fituara që rezultojnë nga veprimtaria e filialeve të likuiduara dhe fondet e tyre financiare vihen në dispozicion të Shoqërisë pasi të jenë kryer pagesat ndaj kreditorëve

N E N I 25

Ky statut është përgatitur në dy kopje ,në gjuhën shqipe dhe në gjuhën çeke , që të dyja kanë të njëjtën vlerë :

Për palën Çeke : Z.Ruy Alves
Për palën Shqiptare : Z. Spartak Shiko
Për palën Braziliane : Z.Ruy Alves

Tiranë më 15.10.1993

